



Pranuar / Dorezuar Prilijena / Prilijena Received / Delivory	19-04	2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot. No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKDMSHCK	2228/2022		113	



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.212/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.212/2022 të datës 07.03.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi kundër organit të punësimit/ Komunës së Vitisë, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 19.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.212/2022 të datës 07.03.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi me datë 07.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të datës 07.02.2022 të Burimeve Njerëzore të Komunës së Vitisë, lidhur me mos pranimin e tij si ekspert i jashtëm sipas shpalljes publike të datës 24.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokollit 1211/2022 të datës 07.03.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Konkursin me numër 02-111/01-24 të datës 13.01.2022; Emalin e datës 07.02.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës nuk është kompetent për

vendosur për ankesën A.nr.212/2022 të datës 07.03.2022, të parashtruar nga ankuesi
SEPSE:

Nga vlerësimi i shkresave të lëndës rezulton se Komuna e Vitisë ka publikuar Shpalljen Publike me numër 02-111/01-24 të datës 13.01.2022, për një (1) Ekspert të Jashtëm, për të qenë pjesë e Komisionit në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit të kandidatëve për konkuret në pranim në fushën e përzgjedhjes, vlerësimit të burimeve njerëzore nga organizata të specializuara apo universitetet e fushës, e për të cilën pozitë ankuesi kishte shpreh interesim dhe i njëjti kishte aplikuar.

Njësia e Burimeve Njerëzore të Komunës së Vitisë me datë 07.02.2021, përmes adresës elektronike të ankuesit ka njoftuar të njëjtin lidhur me kandidatin e përzgjedhur për ekspert të jashtëm sipas Shpalljes Publike të datës 13.01.2022.

Ankuesi i pa kënaqur me mos përzgjedhjen, parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me pretendimet ankimore së janë bërë shkelje të dispozitave ligjore, pasi që i njëjti nuk është ftuar as në intervistë me shkrim e as në intervistë me gojë, nuk është bërë asnjë njoftim publik lidhur me kandidatin e përzgjedhur, si dhe nuk është lejuar e drejta e ankesës.

Kolegji i Këshillit në kuptim të nenit 4 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë konston se nëpunës civil është zyrtari publik në kuadër të Shërbimit Civil, i cili ushtron detyrën në një pozitë, duke filluar nga zyrtari profesional deri në pozitën e sekretarit të përgjithshëm në administratën e Presidentit, në administratën e Kuvendit, në Zyrën e Kryeministrit, në ministri, në agjenci ekzekutive, në agjenci dhe në një degë lokale të tyre, në administratën e institucioneve të sistemit të drejtësisë, në institucion të pavarur, në agjenci të pavarur, në administratën komunale dhe çdo nëpunës i përcaktuar drejtpërdrejt me ligj të veçantë, ndërsa neni 34 i po këtij ligji ka përcaktuar: *1. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj, pranimi në Shërbimin Civil bëhet në kategorinë profesionale në grupin e administrimit të përgjithshëm dhe në secilin nga grupet e administrimit të veçantë. 2. Pranimi në kategorinë profesionale bëhet nëpërmjet një konkurrimi të hapur dhe publik. Konkurrimi organizohet në mënyrë periodike dhe sipas nevojave dhe së paku një herë në vit, për grupin e administrimit të përgjithshëm dhe për secilin nga grupet e administrimit të veçantë.*

Kolegji po ashtu ka analizuar dispozitat e nenit 18 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me të cilin theksohet se: *Për konkurimin në një Institucion Tjetër Shtetëror, institucioni themelon një Komision Pranimi për të gjitha Grupet për të cilat zhvillohet konkurimi. 2. Komisioni i Pranimi në pajtim me paragrafin 1 të këtij neni përbëhet nga: 2.1. një (1) anëtar nga Njësia Përgjegjëse, i cili kryeson komisionin; 2.2. tre (3) anëtarë nga nëpunësit civilë të nivelit të ulët apo të mesëm drejtues që ushtrjnë detyrën në pozita punë të specializuara lidhur me fushën e njohurive, aftësive dhe cilësive për të cilat kryhet vlerësimi i kandidatëve; 2.3. një (1) ekspert i jashtëm në fushën e përzgjedhjes/vlerësimit të burimeve njerëzore, nga organizata të specializuara apo universitetet e fushë, dhe rrjedhimisht Kolegji vlerëson së pozita ekspert i jashtëm për të marrë pjesë në cilësi të anëtarit të Komisionit të pranimi të stafit profesional në shërbim civil, nuk konsiderohet pozitë e nëpunësit civil, andaj duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet së Këshilli është kompetent për të shqyrtuar dhe vendosur ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbim Civil, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk*

është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankuesit
datës 07.03.2022.

A.nr.212/2022 të

Kështu që, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.212/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Vitisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Vitisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

